

VENDIM
Nr. 473, datë 30.7.2021

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.4.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “PALLATI ME SHIGJETA – RRETHROTULLIMI ‘SHQIPONJA’, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 231, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, shifra “... 1 796 862 708.1 (një miliard e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetë pikë një) lekë ...” zëvendësohet me “... 1 823 573 684.1 (një miliard e tetëqind e njëzet e tre milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër pikë një) lekë ...”;

b) Në pikën 4, shifra “... 1 796 862 708.1 (një miliard e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetë pikë një) lekë ...” zëvendësohet me “... 1 823 573 684.1 (një miliard e tetëqind e njëzet e tre milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e katër pikë një) lekë ...” dhe shifra “... 317 006 417.80 (treqind e shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë) lekë ...” zëvendësohet me “... 343 717 393.80 (treqind e dyzet e tre milionë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë treqind e nëntëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë) lekë ...”.

c) Tabelave bashkëlidhur vendimit u shtohet edhe tabela C, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera e shpenzimeve procedurale prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh të përballohet nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 231, DATË 17.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR, PALLATI ME SHIGJETA – RRETHRROTULLIMI SHQIPONJA”, I NDRYSHUAR.

TABELA C

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Z.K.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale/m ²	Sip. e shpronësuar/m ²	Çmimi në lekë /m ²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Xhemal Haziz Gaçi	8310	11/695	Truall	2400	855.6	31,219	26,710,976	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera totale					2,400.0	959		26,710,976	

Shënime.

1. Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e bartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

